

**MUAXHER HARUNI**

*Fëmijë të dashur,  
Ja po j'ua them:  
- Edhe në liri, i lirë nuk jam,  
Edhe në ferrë e as kaçubë,  
Të lirë s'më lënë.  
Dhe nga vendlindja,  
Duan t`më largojnë,  
Se këngën time,  
S`duan ta dëgjojnë.*

\* \*

\*

*Andaj, të dashur fëmijë,  
Juve ju ftoj.  
Me guxim e dije,  
Ëndrrat t`i realizojmë.*

\* \*

\*

*Ndaj, dua tok me shokët,  
T`jemi më të ditur.  
Që në jetë, ne të kemi,  
Ardhmëri më t`ndritur!*

**Ëndërrime**

MUAXHER HARUNI

# Ëndërrime

(Poezi për fëmijë)

Tetovë, 2024

*Redaktor: Aqif Isaku*

*Recensent: Mr.Sadije Aliti*

*Lektore: Mr.Sadije Aliti*

*Korrektor: Arta Velija*

*Realizimi kompjuterik: Emine Haruni*

*Ballina: Emin Haruni*

*Botues: Muaxher Haruni*

*Shtypi: Tringa Design – Tetovë*

*Tirazhi: 300*

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
"Св. Климент Охридски", Скопје

821.18(497.7)-1

HARUNI, Muaxher

Ëndrrërimë : (poezi për fëmijë) / Muaxher Haruni. - Tetovë : M.  
Haruni, 2024 (Tetovë : Tringa Design). - 112 стр. ; 21 см

ISBN 978-608-67179-0-2

COBISS.MK-ID 63505669

## **Ëndrra e jetës**

## DËSHIRA E ARMENDIT

Armendi në farmaci,  
Barna, Antikovit kërkoi.  
Farmacisti, si profesionist i rrallë,  
Me radhë, llojet e barnave i'a tregoi.

Dhe e pyet Armendin:  
- Cilat vitamina i do,  
Të lutem më trego?  
Ndoshta mjeku të ka rekomanduar,  
Antioksidant për të konsumuar?

I hutuar nga situata,  
Armendi mezi belbëzoi!  
Ndaj, farmacistit i tha:  
Xhaxhi, abetaren mësuësja,  
Nga shtëpia na e mëson.  
Unë desha barna,  
Që virusin e mjerë,  
Më shpejt ta largoj,  
Në shkollë me mësuësen  
Sërish të takohem,  
Dhe mësimet drejtpërdrejt,  
Nga ajo t'i dëgjoj!

## **MBRETËRIA IME**

Në mbretërinë time,  
Unë mirë jetoj,  
Askujt si bëj keq  
Dhe askënd nuk dëmtoj.

Në mbretërinë time,  
Të gjithë të lumtur jetojmë,  
Vallëzojmë kapur dorë për dore,  
Dhe këngës me gaz ia fillojmë.

Në mbretërinë time,  
Të gjithë mbretër janë,  
Edhe fëmijët realizojnë,  
Ëndrrat e tyre që kanë.

Në mbretërinë time  
Të rinjtë pallate ndërtojnë,  
Dhe me vullnet e dije,  
Jetën e përparojnë!

Në mbretërinë time,  
Gjyshërit pleqërinë e shijojnë,  
Dhe nipërve e mbesave përralla,  
Për mbretërinë e tyre u tregojnë.

Sa të lumtur do të ishim,  
Të kishim, si e imja mbretëri.  
Fytyrat do të na buzëqeshin,  
Dhe s`do të kishte fare zili!

## FAJI

Nora vendosi nënës t'i ndihmojë,  
Gotat e kristalta t'ia pastrojë.  
Gota Norës nga dora i ra,  
E në shumë pjesë u shpërnda.

Nëna Norën e qortoi,  
Nora fajin nuk e pranoi,  
Gota tha, nga banaku vetë rrëshqiti,  
Rra poshtë dhe mua më tronditi.

Me top Mili deshi ta gjuajë Norën,  
Topi i rëndë i'a shtrembëroi dorën.  
Xha Xhelos i'a theu xhamin,  
Dhe në mëhallë e bëri namin.

Xha Xheloja Milin e qortoi,  
Por Mili fajin nuk e pranoi,  
Topi fajin, tha xhaxhi e ka  
Fluturoi vetë e në xham ra.



Fëmijë duhet të kuptoni,  
Si Nora e Mili të mos veproni,  
Gjërat në shtëpi mos i dëmtoni.

Të tjerët mos i akuzoni,  
Fajin guximshëm ta pranoni,  
Kur gjërat vetë i dëmtoni.

## ERA E DIELLI

Dielli me erën,  
U vunë në garë,  
Se cili Benit,  
Pallton, t'ia largojë më parë.

E para garën,  
E filloi era,  
Fryu furishëm,  
Me tërë fuqinë e saj.  
Por pallton Benit,  
Nuk i'a largoi,  
Sepse ai,  
Për trupi e shtrëngoi.

Më pas Dielli,  
I shpërndau retë,  
Moti u ngroh,  
I kapluar nga vapa,  
Pallton Beni,  
E hoqi vetë!

Fitimtar u shpall Dielli,  
Dhe një mesazh na dha:

Bindja duhet vlerësuar,  
E mira duhet pranuar.  
Me forcë asgjë s`bëhet,  
Ndaj, e keqja të dëbohet.

## RONI E HËNA

Ëndërronte Roni,  
Në hënë si të shkonte.  
Ndaj çdo natë në dritare,  
Me të kuvendonte.

Një mbrëmje verore,  
Kur hëna në qiell nusëronte,  
Roni me shumë ëndje,  
Atë e shikonte!

Ndaj iu kthye Roni,  
Hënës lozonjare,  
Që ishte e rrethuar,  
Me mijëra fanare!

- Po të lutem hënë,  
Zbritmë në liqe,  
Që t`më falësh ëndrrën,  
Në mbrëmje kur fle!

Qeshi nga lart hëna,  
Dhe rrezet lëshoi,  
Sikur nënë me to,  
Ronin e mikloi!

E Roni çapkën,  
Flinte ëmbël, qetë...  
Se hëna e bukur,  
Ndriste mbi liqe!

## HËNËS

Më buzëqesh e bukura hënë,  
Të jemi mike përgjithmonë.  
Të krijojmë ne miqësi,  
Me Ty yllkë që ndrit në gjithësi!

Përmbi bjeshkë, Hënë, kur je,  
Pse në fushë mua më lë?!  
Edhe unë maleve dua të udhëtoj,  
Fëmijëve, në gjumë ëndrra t'iu dhuroj!

Sa e bukur, e sa magjike,  
Dukesh, kur shëndrit, qiellit ti mike!  
Pse s`më fton, dhe mua në shoqëri,  
Mos ta prish, vallë atë bukuri!?

Jo, jo, mike, nuk të shëmtoj,  
Por më shumë do të zbukuroj!  
Ndaj, merrmë, të lozim qiellit,  
Fluturuar mbi krahë të ylberit!

Dhe aty nga gjithësia,  
Ku mbretëron natën qetësia!  
Fëmijëve dëshirat t'ua plotësojmë,  
Ëndrra të ëmbla kur t'ju dhurojmë!

Do t'u falim nga një shkop magjik,  
Që detyrat t'i kryejnë më vrik!  
Të shkruajnë dhe poezi,  
T'na lëvdojnë mua dhe ty!

## FËMIJËVE TË BOTËS

Për çdo natë,  
Lexojmë e dëgjojmë.  
Në vatra të luftës,  
Fëmijët se ç`pësojnë.

A ka gjë më të dhimbshme,  
Po edhe mizori,  
Në prag të shtëpisë,  
Të vritet një fëmijë!?

Ç'faj kanë fëmijët,  
Që vriten pa mëshirë!?  
Për hesape të palara,  
Të të rriturve, e për dëshirë.

Le të shndërrohet gjaku i tyre,  
Në simbol paqe e lirie.  
Të mos ketë më luftë në botë,  
Të mos ketë vuajte fëmijë!



## DUA TË DI

Dua të di, keq kujt i bëra,  
Dua të di, kë e hidhërova!  
Dua të di, rahat pse nuk më lini,  
Se nuk u pengoj, ju mirë e dini.

Pse për çdo vit,  
Dy tri herë, më lëndoni?!  
Pse më shkaktoni plagë,  
Kur të njëjtat nuk m'i shëroni!?

Dua ta di, kujt i pengoj,  
Dua ta di,  
Pse nga vendlindja,  
Me çdo kusht,  
Dëshironi të shtegtoj!?

Dua të di shumë,  
Shumëçka dua të di!  
Rreth jetës sime,  
Dua të di!

Nga ajo që kaluam,  
Siç duket, fare nuk mësuam,  
Dua të di,  
Se ç'e pret timen ardhmëri!?

## KURESHTARËT

Loni një ditë më pyeti  
Kush e pikturon vjeshtën,  
Kush ia hedh ngjyrat natyrës,  
Që kaq e zbukuron.

Edhe Arta mezi priti të pyesë,  
Që unë t'i tregoj,  
Kodrat që na rrethojnë  
Ngjyrat lara-lara nga i fitojnë?

Beni si Beni, tepër kurioz ishte,  
Pyeti për lejlek e për dallëndyshe,  
Në vjeshtë ku ikin, ku shkojnë vallë,  
Mos e kalojnë dimrin, diku në përrallë!?

Dhe shumë pyetje tjera,  
Nga fëmijët vinin si ngaherë.  
Pyesnin pa reshtur,  
Për gjithçka që nuk dinin.

Dhe për bujkun pyesnin  
Dhe bariun anash nuk e linin,  
Pas çdo përgjigje që merrnin  
Pa parashtruar pyetje nuk rrinin.

## Ç'TË BËHEM?

Të bëhem konstruktor,  
Fluturake, fëmijëve t'u ndërtoj.  
Të fluturojnë galaktikës,  
Të zbulojnë se çka ekziston.

Të bëhem aviator,  
Në qiell të fluturoj.  
Në hënë a në mars,  
Me anije të shkoj.

Të bëhem mjek,  
Barna të zbuloj.  
Që fëmijët e vegjël,  
Me gjilpëra mos i shpojnë.

Të bëhem inxhinier,  
Godina shkollore të ndërtoj.  
Që fëmijët e vegjël,  
Të kenë, ku të mësojnë.

Dua të bëhem mësues,  
Fëmijët t'i mësoj.  
Që punë e dije,  
Atdheun ta përparojnë.

## ËNDRRA IME

Dua, një anie kozmike,  
Edhe unë të ndërtoj.  
Ëndrën e jetës sime,  
Që ta realizoj.

Të fluturoj në gjithësi,  
Hënës për rreth t'i kaloj.  
E në Mars shtëpi,  
Një ditë ta ndërtoj.

Nga shtëpia ime,  
Jupiterin, Venerën,  
Uranin e Merkurin,  
Më mirë t'i vëzhgoj.

Të jetoj i lumtur,  
Me plot dashuri,  
Me miq përreth meje,  
Pa urrejtje e xhelozë.

Ëndrën time dua,  
Shpresoj ta realizoj.  
Duke lexuar libra,  
Mësimet t`i mësoj.

Andaj, të dashur fëmijë,  
Juve ju ftoj.  
Me guxim e dije,  
Ëndrrat t`i realizojmë.

## DUA

Dua një laps magjik,  
Edhe libër magjik dua!  
T`më ndihmojnë në mësim,  
Që të jetë lehtë për mua!

Sa gëzim do të ishte,  
Kur në shkollë të shkoja.  
Dhe me dije, mbushur plot,  
Shokëve t`u ndihmoja.

Sepse, s`dua i vetëm,  
Në dije të jem i pari.  
Se në kokë këtë e ka,  
Vetëm ai i marri.

Ndaj, dua tok me shokët,  
Të jemi më të ditur.  
Që në jetë, ne të kemi,  
Ardhmëri më të ndritur!

## DHURATA

Edhe unë dua dhurata  
Sikur Beni, e sikur Arta.  
Dua laptop apo tablet,  
Që të shkruajë poezi vetë.

Këtë dhuratë unë e dua,  
T`më mësojnë të shkruaj mua.  
Që një ditë libër të botoj,  
Ëndrën time ta realizoj.

Qeshi gjyshja me të madhe,  
I thotë mbesës, të kam sorkadhe!  
Eh, sa bukur të është kujtuar,  
Do t`më kushtojë poezi edhe mua!

Edhe gjyshi me shaka,  
I thotë: po për mua vargje s`ka!?  
I kthen Nora me qetësi,  
Do shkruaj një libër për ty!

Sa gëzim për babë e nënë,  
Që e kanë vajzën e bukur si Hënë!  
Shpejt e shpejtë laptop i blenë,  
Që më shpejt libri të vjen.

## ARDHMËRISË

Po lind një rini,  
E cila më së miri do të dijë.  
Shkencën në pedestal ta lartësojë,  
Ardhmëri në vendlindje të sigurojë.

Kam besim te kjo rini,  
Që po vjen si uragani.  
Të vjetrën ajo do ta shkatërrojë  
E mbi të, e reja do të lulëzojë.

Këtë fuqi, ju lutem, mos e prekni,  
Mos tentoni as rrugën t'ia ndryshoni.  
Se po tentuat, shumë keq do t' u dalë,  
Dhe nga goja s' do t' ju dalë asnjë fjalë!

Ju ftoj dhe juve, e ardhmja rini,  
Ndryshojeni botën, krijoni ardhmëri.  
Mos ndaloni, sa nuk është vonë dot,  
Qe e nesërmja të jetë më e bukur se sot!

Krijoni botën magjike, botën tuaj,  
Mos lejoni t'iu udhëheq dorë e huaj.  
Ardhmërinë që t'ua shkatërrojë,  
Dhe me jetën tuaj të manipulojë!



## BUZËQESH

Sot fillon shkolla,  
Ndaj, fillorist buzëqesh!  
Se dita e mirë,  
Shihet që në mëngjes!

Buzëqeshni edhe ju,  
Nxënës të tjerë.  
Se ju presin shumë sfida,  
Në rrugëtimin tuaj në jetë.

Buzëqeshni prind,  
Gëzohuni me fëmijët tuaj,  
Se pas dritës së dijes,  
Të palodhur vrapojnë.

Ti o Gjysh,  
Buzëqeshjen mos e freno!  
Se në fytyrë gazi,  
Bukur të qëndron.

Gëzohu, se nipërit e mbesat,  
Për jetë më të lumtur mësojnë.

## MË TË SHTRËNJTËS

Cila vlen më shumë:

- Një lule që rritet një vit,  
A fjalët e mira çdo ditë?!

Fjalët e mira, që thuhet çdo ditë,  
Kanë vlerë sa një botë,  
Të gëzohemi me njerëz të tillë:  
- Lum ai që ato i thotë!

Fjala më e bukur e më e ëmbël,  
Është fjala e nënës kur thotë:  
- Je engjëllushja ime, je engjëlli im,  
Dhe të dua, sa të madhen botë!

Ndaj, nënat duhet t`i duam,  
Edhe lule, prorre t`ju dhurojmë.  
Sepse, ato na rritën, na edukuan,  
Dhe me fjalë të ëmbla na ledhatojnë.

Çdo ditë nënën ta respektojmë,  
Se ajo është burim i dashurisë,  
Është bukuri e shpirtit, e votrës  
Është vetë jeta e mbarë njerëzisë.

## 8 MARS

Ejani, ejani,  
Ju o fëmijë,  
Ta festojmë festën,  
Me shumë lumturi.

Për ditën e nënës,  
Ato t'i përqafojmë,  
Festën e 8 Marsit  
Ne t'ua urojmë.

T'ua urojmë me lule,  
Dhe shumë përqaftime.  
Se nënën e dashur,  
E kam në zemrën time.

## PRINDËRVE

Babai dhe Nëna,  
Janë si dielli e hëna.  
Fjalë e parë e çdo fëmije,  
Është Babë e Nënë  
Që ata e thonë.  
Pa to, jeta s'ka kuptim,  
Me to jeta s'ka mbarim,  
Për lumturinë tonë,  
Jetën shkrijnë si qiri.

Prindër të dashur,  
Tërë jetën punuat,  
Të edukohem e shkollohem.  
Jeni ata,  
Që çdo gjë bëtë për mua,  
Ndaj, babë e nënë,  
Unë shumë u dua!  
Fjalët babë e nënë,  
Me katër shkronja shkruar,  
Peshojnë sa katër botë,  
Ndaj prindërit,  
Mos t'i harrojmë dot!

## VITI I RI

Urimet si lumë,  
Rrjedhin pa pushim,  
Të përcjellim Vitin e Vjetër,  
Ti mirëgëzojmë rrugëtim.

Ta presim të riun,  
Me gaz e hare,  
Lumturi, si nga hera,  
Që të sjell tek ne!

Lumturi, shëndet,  
Dhe shumë pasuri,  
Të na sjellë prore,  
Dhe ky Vit i Ri!

Por, të mos presim pra,  
Nga ëndrra të presim,  
Se as bukë as dije,  
Pa punë nuk ta qesin!

Ndaj përveshni krahët,  
Edhe punës rrekni.  
Të jetoni të lumtur,  
Pa të mira të mos mbetni!

## DIKUR E SOT

Dikur mblidheshin bashkë,  
Rreth sofrës së madhe.  
Loznim e kuvendonim,  
E s`vajtonim për halle.

Sot, as në jetën imagjinare,  
E as në jetën reale,  
S`tubohemi si më parë,  
As në mort e as festë.

Dikur në dhoma të vogla,  
Kokë më kokë qëndronim.  
Sot në sallone të mëdha,  
Një orë së bashku se bënim.

Dikur ... eh dikur...!  
Ndoshta të varfër ishim,  
Por në shtëpitë tona,  
Lumturi kishim.

Tani vajtojnë për familjarët,  
Që si shohin me vite.  
Mbetën rrugëve të mërgimit,  
E në vend të huaj, fole ngritën.

## KËNGË JEHO

Jeho e bukura këngë,  
Fushë e male të gjëmojnë.  
Të dëgjohet gjithandej,  
Kënga e bukur e vendit tonë.

Jeho, jeho, ti o këngë,  
Këngë e brezit tim!  
Këngë e së bukurës rini,  
Këngë e së shenjtës ardhmëri!

Jeho këngë, në dasma e festivale,  
Jeho e kurrë mos ndalo!  
Se ti këngë na shëron plagët,  
Dhe shpirtin na e qetëson!

## FJALË E PUNË

Puna bën kalanë,  
Fjala bën hatanë,  
Kështu kishin thënë dikur moti,  
Jo nga qejfi e as nga zori.

Përvoja i kishte mësuar,  
Jeta i kishte detyruar,  
Të punojnë e të mësojnë,  
E gjithë kohës të luftojnë,  
Në këtë botë të mbijetojnë.

Fjala fjalën e fton,  
Ligjëratën e ndërton.  
Herë mirë kuptohet,  
Herë keq ndërtohet,  
Varësisht se, si interpretohet.

Dikush dembel e dikush nuk rri,  
Secili punon për veten e tij.  
Puno sot, që të kesh ardhmëri  
Të kesh mirëqenie e lumturi.



Njeriu që vetëm për vete punon,  
Është si një dru që pemë s'lëshon.  
Puna të jep vlerë, të bën njeri,  
Nëse prej saj kanë të gjithë dobi.

Më shumë punë, e më pak fjalë,  
Dikur thoshin të parët tanë.  
Ndokush këto fjalë i urren,  
Se të vërtetën nuk e pëlqen.

## FJALA

Fjala e thënë,  
Si fjala e dhënë.  
Po se mbajte të mallkon,  
E tërë jetën lëngon.

Fjala e thënë,  
Peshon sa një botë e tërë.  
Të qëllon, të lëndon,  
Të përvëlon, e të shëmton.

Fjala e thënë,  
Shkatërron një botë.  
Kur e thua me shpejtësi,  
Kur s`e matën dot!

Fjala e thënë,  
Plagët e rënda shëron.  
Është si melhem,  
Kur ëmbël tingëllon!

Ndaj, mate fjalën,  
Kur me miq flet.  
Se fjala e ligë,  
Porsi thikë të pret!

## FËMIJËVE TË BOTËS

Për çdo natë,  
Lexojmë e dëgjojmë.  
Në vatra të luftës,  
Fëmijët se ç`pësojnë.

A ka gjë më të dhimbshme,  
Po dhe mizori,  
Në prag të shtëpisë,  
Të vritet një fëmijë!?

Ç'faj kanë fëmijët,  
Që vriten pa mëshirë!?  
Për hesape të palara,  
Të të rriturve, e për dëshirë.

Le të shndërrohet gjaku i tyre,  
Në simbol paqe e lirie.  
Të mos ketë më luftë në botë,  
Të mos ketë vuajte fëmijë!

## JUVE

Mos më shani e lavdëroni,  
Juve, që në këmbë u mësova të qëndroni,  
Po Ju që sot vraponi, çdo më thoni,  
Edhe ju do t`më qortoni?!

E Ju që në maratonë mirë qëndroni,  
Ç`mëkat do më shtoni?!

Ju që për një kohë të shkurt,  
Rezultate të lakmueshme keni arritur,  
Edhe Ju të kënaqur nuk jeni?!

Ç`të bëj unë, tjetër s`bëhem dot,  
Aq sa dija, aq sa munda,  
Dituri i`u dhurova,  
Trashëgimi tjetër nuk pata,  
Pasurinë më të mirë ua trashëgova.

## HIDHËRIMI

Edhe hidhërimi ka kufi.  
Hidhërohu me çdo kënd,  
Aq sa ai peshon me dituri.

Mos u hidhëro me të,  
Që në fytyrë troç të thotë.  
Hidhërohu me të, që pas shine,  
Mundohet që gropën të ta hapë.

Sa të mjerë e mjeranë,  
Ca njerëz janë në këtë botë!  
Gjithmonë varrin për të tjerët bëjnë,  
E të njëjtin, gjithmonë vetë e zënë.

Fjala e drejtë është e shkurtër,  
Sepse me të, troç gjërat thuhën.  
Fjala e shtrembër është e gjatë,  
Se del nga goja e njerëzve të ngratë!

Mos u hidhëro, të lutem,  
Nga ai që nga hija e tij frikohet.  
Po nuk e njohe hidhërimin,  
Nuk do të kuptosh dhe gëzimin.

## KOHA FLET

Mos më trego kush je,  
Lere vepra jote të flasë,  
Të të tregojë fytyrën e vërtetë.

Edhe veshmbathja,  
Nuk të lartëson.  
Edhe titujt, të mençur s` të bëjë,  
Dije, dituri, e profesion nuk të tregojnë.

Mbahesh i ditur, studiues e letrar,  
Trumbeton se je shkencëtar.  
Të gjithë me rend i ofendon,  
E veten, deri në qiell e lartëson.

Koha flet, të vërtetën tregon  
Të tillë ka plot në këtë botë,  
Fjalë plot, “trim e patriot”,  
Punë pak, fjalë bosh e të marrë,  
Vetëm hija u bëhet dëshmitar.

## MOS MË QUAJ POET

Më thërrasin poet,  
Jo që s'më pëlqen ky epitete,  
Edhe unë mundohem të krijoj,  
Mundohem me fjalë,  
Të gdhendi realitet.

Në vargjet e mia,  
Të paraqes një pjesë të jetës,  
E tjetrën ta kem sekret.

Krijoj e mundohem,  
Të shkruaj për fenomene.  
E person si i tillë  
Në këto vargje nuk ka vend.

Andaj mos më quaj poet,  
Po thjesht një njeri,  
Që paraqet jetën në vargje,  
Si një realitet,  
Ashtu si e sheh vetë.

## KUR SHKRUAJ VARGJE

Jam shumë i lumtur,  
Kur shkruaj poezi.  
Edhe më i lumtur,  
Kur shkruaj për fëmijë.

Merita me ëndje,  
Poezitë i lexon.  
Bejza, përballë saj,  
Me admirim e shikon.

Gimi dhe Butrinti,  
Mundohen të shkruajnë vargje.  
Me to, të konkurrojnë,  
Në gara letrare.

Edhe nxënës tjerë,  
Kanë talent të shkruajnë.  
Por nga dembelizmi,  
Pak si tepër vuajnë!



## POEZIA

Poezia, nuk bëhet me porosi,  
Si ëmbëlsira që bëhet në pastiçeri.  
Poezia bëhet me inspirim,  
Duhet të ketë mesazh, të ketë kuptim.

Poezi kur të krijoni,  
Me lavde mos e teproni.  
Në të urrejtjen e ofendimin,  
Ju lutem, mos e preferoni!

Xhelozinë e tradhtinë,  
As në fusnotë mos e hartoni,  
Poezinë duhet ta lexojë,  
I bardhë, i verdhë, i zi,  
Çdo fe, racë apo kombësi.

Nuk duhet pasur kufi në poezi,  
Ajo duhet të ketë mesazh,  
Për të gjithë fëmijët e botës mbarë.  
Poezia duhet mirë të kuptohet,  
Pa marrë parasysh në ç' gjuhë krijohet.  
Ajo duhet të ketë,  
Një mijë dritare,  
Nga të cilat duhet,  
Mirëkuptuar Botën e madhe.

## POETI

Poeti, penën armë e ka,  
Ai luftën e bën,  
Me shkronja, të vogla,  
E të mëdha.

Mburojë të vetes,  
Shenjat e pikësimit ka.  
Me ato udhëzon,  
E mendimet drejtë i reflekton.

Shkruan për paqe,  
Shkruan për drejtësi.  
Mundohet të shkruajë,  
Dhe për histori.

Synim i tij  
Është liria,  
Është mirëqenia,  
Është dhe mirësia.

Zemrën humane,  
Nga Zoti e ka dhuratë.  
Ndaj, vargjet e tij,  
Janë të ëmbla mjaltë.

Dhuntinë që ka,  
Është diçka hyjnore.  
Se muza e tij,  
E shoqëron prore.

## PUNA

Nuk dua t`ma vlerësoni gunën,  
Por dua t`ma vlerësoni punën.  
Kishte thënë një plak, dikur më parë,  
E njerëzit e merrnin për të marrë.

Ndaj, vlerëso thënien:  
“Puno sot, kot mos rri”,  
Se shpejt vjen shtriga pleqëri.  
E njeriut i vlen puna,  
Më shumë se një mijë guna.

Edhe toka më pjellore,  
Të mos mirë punohet,  
Me ferra e të egra barishte,  
Ajo do të mbulohet.

Një ditë,  
Po të qëndrosh pa punë,  
Të lodh më shumë,  
Se një natë pa gjumë.

Dembel, e çdo lloj qofshin,  
Janë gjithmonë njerëz mediokër.  
Puna, mirësia e mirësjellja,  
Njeriut, jetën i`a bëjnë të lumtur.

## KËNGË MOJ

Jeho këngë, jeho,  
Se për jeh të kemi krijuar.  
Jeho më e bukura këngë,  
Rinia me zell për të të kënduar.

Nëpër vargje shkruar bukur,  
Kurrë në jetë mos u ndal.  
Dhe, nëse vrullin të ndalojnë,  
Hapin përshpejto, përjetësi krijo.

Në vargje datëlindje shëno,  
Ditë morti të mos ketë.  
Le të jehojë kënga nëpër vargje,  
Në botë, sa të ketë jetë.

Jeho kënga ime,  
Bashkë me zërat e lumturisë.  
Zërat që të zgjatin jetën,  
Zërat e ardhmërisë.

## NË PUNË

Vemi në punë të punojmë,  
Po në fakt, ç'bëjmë?!

Secili të jep mend,  
Secili të këshillon,  
Po në punë vetë ç'bën?

S`ka rëndësi se ç'punë bën,  
Me rëndësi sesi punën e realizon,  
E kush nga puna ç'përfiton?

Edhe pas shtatë kodrash po të shkosh,  
Edhe në fund të botës po të arrish,  
Një punë duhet të bësh,  
- Me nder të jetosh!

Një punë, vetëm një punë,  
Na takon, apo jo?!  
Si parazit të mos jetojmë,  
E tjetër s`kemi ç'të bëjmë.

## PARAJA

Të gjithë e marrin,  
E askush se jep.  
Paranë lakmitare,  
Paranë e shkretë.

Për të në këmbë,  
Është ngritur njerëzia,  
Bëjnë punë të mira,  
Bëjnë edhe marrëzira.

Edhe fëmija,  
Për të vajton,  
Për të qesh kur dikush  
Peshqesh ia dhuron.

Një jetë të tërë,  
Njeriu punon,  
Paranë me djersë,  
Ai e fiton.

Për paranë thuhet,  
Ujin e çon përpjetë.  
Ah, para lakmitare,  
Ah, para e shkretë!

## GËNJESHTARI

Ata që veten gënjejnë,  
E të tjerët i mashtrojnë,  
I quajmë gënjeshtarë,  
Për ta, s`vlen tjetër fjalë.

Edhe fëmijës të gënjejnë,  
As të mashtrojnë, nuk i lejohet.  
Sepse më vonë në jetë,  
Traditë e keqe i bëhet.

S`ka më keq e më marrëzi,  
Kur i rrituri të gënjen ndër sy.  
E për të, nuk pendohet,  
Dhe me këmbëngulje mbrohet.

Edhe më zi s`ka ku shkon,  
Kur intelektual i të mashtron.  
Të mashtron, e s`i skuqet fytyra,  
Për pak interes, e shumë dëshira.



## **RILINDJE**

Po lind dita, ditë e bekuar,  
Po lind dita, ditë e harruar,  
Po lind dielli, i shteruar,  
Po rilind fati, i harruar.  
Po rikthej veten,  
Nga ëndrra e trishtuar,  
Po rilind vetja,  
Nga kujtesa e harruar.  
Po rilindim edhe një herë,  
Në këtë botë,  
Të trazuar,  
Nga historia e harruar.

Dua të jem vetja,  
Dua veç edhe një herë,  
Kësaj bote të qytetëruar,  
T'i fal trima, trima me vlerë,  
Që për trimërinë e tyre,  
Të paharruar në mendje,  
Të na ngelin përherë!

## FLAKË PËRVËLUESE

Më vendosin në skaje të dhomës,  
Më ndezin kur s'kanë dritë.  
Dhomën t'ua ndriçoj,  
Jetën t'ua zbukuroj.

Edhe pse digjem e shkrumbohem,  
Askush s'dëshiron ta vërejë.  
Pasi të vdes e të harxhohem,  
Mirësitë e mia do i vlerësojnë.

Dritën e flakëve të mia,  
Kur të kërkon,  
Do ta gjeni ndër librat,  
Që do i lexoni.

Dua dritë t'iu bëj,  
Rrugën e jetës t'ua ndriçoj.  
Dua t'iu ndriçoj për ardhmëri,  
Që të jetoni në lumturi!



**Ëndrra e atdheut**

## **NXËNËSI I SHKËLQYESHËM**

Nxënësi i shkëlqyeshëm,  
Në shtëpi mëson,  
Pa u përgatitur,  
Në shkollë nuk shkon.

Kur mësuesi mësimet,  
Në klasë i shpjegon  
Ai me vëmendje,  
Gjithmonë e dëgjon.

Në korridor e oborr,  
Gjithkënd respekton,  
Me fjalë të këqija  
Askënd nuk ofendon.

Në shtëpi prindërve,  
U ndihmon prore,  
Dhe as të mësuarit,  
Nuk e lë pas dore.

## NUMRAT

Pa numrat çdo të bënim,  
Çdo të bënim ne të gjerët  
Nuk do të dinim të numërojmë,  
As edhe llogari të bëjmë.

As edhe kohën kur jetojmë,  
Nuk do të dinim ta shijojmë.  
Në botë gjithçka numërohet,  
E koklavitur apo e thjeshtë,  
Të gjithë kanë vlerën e vetë.

Edhe zero që s`vlerësohet,  
Gjithkund bën pjesë,  
Pas çdo numri edhe ajo shumëzohet,  
Me një kullë baras vlerësohet.

Pa numrat nuk mund të jetojmë,  
Me to e dimë vlerën tonë ndër vite,  
Në çdo kohë që jetojmë,  
Dhe gjithçka me numra vlerësojmë.

## ALFABETIT

Atij, me të cilin shkruajmë,  
Atij me të cilin krijojmë,  
Atij me të cilin lexojmë,  
Atë, që me djersë e gjak e paguam.

Për të cilin, ndër shekuj vuajtëm.  
Që ndër vite brezni e krijuan,  
Dhe në fund, për atë,  
Me vdekje, u dënuan.

Atë, që para njëqind vitesh,  
Në Manastir e krijuan,  
Dhe me shkronjat e arta,  
Dritën e syve na dhuruan.

Atij, që sot, ndër shqiptar  
Shkruhet e lexohet,  
Dhe në gjitha fushat e jetës,  
Ruhet e kultivohet.

Do ta ruajmë me respekt e nder,  
Nuk do të lejojmë që ta përdhosin,  
E ta zhdukin, asnjëherë.  
Se gjuhën tonë do ta sakatosnin.

## KONGRESI I MANASTIRIT

Në Manastir u tubuan,  
Shkrimtarë, poetë e mendimtarë.  
Në mëngjesin e 14 Nëntorit,  
Për të formuar një alfabet kombëtar.

Para kësaj date,  
S'kishim alfabet unik.  
Këtë zvarritje e ushqyen,  
Më shumë se një armik.

Mendimtarët e Shqipes,  
Çështjen e alfabetit ngritën.  
Në krye të komisionit,  
E zgjodhën Gjergj Fishtën.



## NËNTORIT

Nëntor i bekuar,  
Ndër shekuj i lartësuar,  
Që solle guximin,  
Të keqes t'ia vëmë drynin.

Me Skënderbeun,  
Rrugën e fillove,  
Me Ismailin,  
Lirinë e vazhdove.

Ndër shekuj luftuam,  
Për ty shumë sakrifikuam,  
Lirinë, me secilin prijës,  
Me çdo kusht e kërkuam.

Edhe sot për të punojmë,  
Që së bashku në liri,  
Të lirë te jetojmë,  
E vuajtjet tona,  
Kurrë mos t'i harrojmë.

## NDËR KOHËRA

Thellë në shpatet e Sharrit,  
Të parët e mi i kanë varret.  
Ndër male e lugina, hije rëndë qëndron,  
Si feniks shndrisin lashtësinë tonë.

Atje përtej bjeshkëve,  
Lindën stërgjyshërit e mi.  
Në ato kushte të rënda,  
Krijuan jetë, krijuan ardhmëri.

Ndër ato bjeshkë, e ndër ato male,  
Të vetme, veç zanat sot aty kanë ngelur.  
Çdo gjë në gërmadha është shndërruar,  
Sikur këmbë njeriu më aty s`ka shkelur!

## VENDI IM

Më të bukur në këtë nënqiell,  
Se vendi im nuk ka.  
Zoti e krijoi aq të bukur  
Sa për reklamë, nevojë s`ka.

Ku po shkoni o ju të rinj,  
Vendin pse e lini?!  
Rikujtoni gjyshërit tanë,  
Edhe në gurë bukën e gjenin.

Jetë më të lumtur se në vendlindje,  
S`mund të gjeni kund.  
Në mërgim malli ju merr,  
Për çdo qytet e katund.

Edhe gjumin më të ëmbël,  
Në mërgim s`mund ta bëni.  
Ëndrrën më të bukur,  
Në vendlindje e ëndërroni.

Mos e harroni vendin tuaj,  
Atë perlë hyjnore!  
Se në të, të lumtur kaluat,  
Ditët fëmijërore.

Ndaj, nipërve e mbesave,  
Ju flisni për vendin tuaj,  
Që të mos të ndodh për ta,  
Të jetë vendi i huaj.

## DHEU I ATDHEUT TIM

Sa dhe' të bukur, ka ky atdhe,  
E ky Dhe' ka ngelur jetim.  
Për ta punuar këtë dhe,  
Të ikën djemtë dhe vajzat,  
Në tjetër Dhe', o Atdheu im!

O dheu i bukur i atdheut tim,  
Në dorë të kujt mbete,  
Tani, ti më dukesh,  
Më tepër se një jetim.

Sot në dheun e atdheut tim,  
Lloj-lloj ferrash e barishtesh mbijnë  
Sa keq o i imi atdhe,  
Që ta humbin bukurinë,

Eh, me sa mburrje dikur,  
Flitej për ty o dhe'!  
Ti ishe shembull pastërtie...  
Ishe dhe flori për ne!

## HERONJTË

Heronjtë e heshtur,  
Ju lutem t`i dëgjoni,  
Punët e tyre t`i mirëkuptoni.  
Zhurmaxhitë, zhurmë bëjnë,  
Shumë flasin e asgjë s`thonë.  
Heronj të heshtur gjithandej ka,  
Pak flasin e shumë thonë.  
Punën me nder gjithmonë e bëjnë,  
Shërbime e nder, për punët e bëra,  
Askujt nuk i kërkojnë.  
Hero i heshtur është çdo njeri,  
Qoftë i rritur apo fëmijë,  
Që punën e vet e bëjnë për mrekulli.  
Zhurmaxhitë, zhurmën e bëjnë me qëllim,  
Të mbulojnë mosdije, të kenë dominim,  
Dhe mbi të gjitha, heronjtë t`i dominojnë,  
Të drejtën e tyre ta mbisundojnë.



## **Ëndrra e shqiponjës**



## GARË EPIKE

Në një garë epike,  
Breshka dhe Lepuri,  
Vendosën të garojnë,  
Në garë maratonike,  
Shtegun ta kalojnë.

Lepurush mendjelehti,  
Lazdrak e këmbëshpejtë,  
Gjithandej lëvdohej,  
Garën do ta fitojë,  
Breshkës do t'ia kalojë.

Si gjithmonë breshka,  
E heshtur ishte.  
Plan të mirë hartoi,  
Garën, që ta fitojë.

Dhe nisi vrapin,  
Qetë si ngaherë,  
Lepurush veshgjati,  
Ra vetë në sherr.

Se breshka ecte,  
E s`ndalej dot.  
Ashtu siç bënte,  
Për jetë e mot!

Lepurushi, ikte,  
Fluturimthi me vrap,  
Pastaj shtrihej,  
Të flinte nën rrap.

Kështu i gjori,  
Nga mendjemadhësia pësoi,  
Se breshka garën,  
Me meritë e fitoi!

## KONKURSI

Për këngëtar më të mirë  
Shpesët konkurs kishin shpallë,  
Ca zogj shpejt vrapuan,  
Pjesëmarrje në garë për të marrë.

I pari këngës,  
Këndesi i'a mori,  
Që në mëngjes,  
Mëhallën e zgjoi.

Edhe zëri i bilbilit,  
Nga kaçuba u dëgjua,  
Për këngën e bukur,  
Fëmijët e lëvduan.

Edhe zogjtë tjerë,  
Në kor tok kënduan,  
Këngët më të bukura,  
Neve na i dhuruan.

Korbi nga inati,  
Këngës i'a filloi,  
Por krokamën e tij,  
Askush s`e dëgjo!

As këngë e gjinkallës,  
Nuk la fare shije,  
Ndaj shpejtë u largua,  
Të mrizojnë nën hije!

## DHELPA DHE GJELI

Nga mali zbret një dhel për plakë,  
Për të gjet ushqim për dimrin e gjatë.  
Në një degë lisi Gjeli këngës ia nisi,  
Mëngjesin të paralajmërojë,  
Njerëzit nga gjumi t'i zgjojë.

Dhelpra gjelin e ftoi,  
Të rimë pak bashkë, i thotë:  
Të flasim e të kuvendojmë,  
Një shtëpi bashkë të bëjmë.

I thotë gjeli sa dëshiroj,  
Zanatin tënd që ta mësoj.  
Intrigat e tua fort mirë i di,  
Ndaj ne s'mund të lidhim miqësi!

U mundua dhelpra e shkretë,  
Të mashtrojë gjelin, e në tokë ta zbrësë.  
Mirë po të shkretës, i shkoi puna huq,  
Kur pas shpine i erdhi Bala i kuq.

## STALLA

Në stallën e Xha Qamilit  
Shumë lopë kishte,  
Ndër to më e bukura,  
Ajo me lule në ballë ishte.

Në kullotë kur i dërgonin  
Lopës Larë këmborën ia vendonin.  
Thoshte ajo, unë rrugën e di  
Me gjithë tufën kthehemi në shtëpi.

Lopa e madhe pëllet,  
Sikur të thotë: viçi im është talent,  
Nga livadhi nuk largohet  
Që nga stalla, ai me zell edukohet.

Ndaj, lopët tjera i qorton,  
Viçat e tyre t`i mësojnë.  
Të mos ecin rrugës me vrap,  
Kur shkojnë për në livadh.

Xha Qamili, për të mos u nervozuar,  
Me lopët duhet ndryshe me punuar.  
Lopë dhe viçat që nuk ndërrojnë ves,  
Duhet t`i nxjerr në pazar e t`i shesë.

## PËLLUMBAT

Xha Dino ditë për ditë lëvdohet,  
Si pëllumbat e mi, thotë nuk ka,  
Fluturojnë qiellit si avionë lart,  
Sa që dhe diellit i afrohen ngatë.

Legjenda të vjetra për to tregohen,  
Se pëllumbit Ilir, s'ia kalon kush,  
Me flatra kur ngjitet qiellit,  
Ç`me gëzim zemrat na i mbush!

Si shqiponjat kur i bëhen roje atdheut,  
Fluturojnë qiellit të kaltëruar,  
Por pronarin e tyre, dhe as tokë e fole,  
Kurrë s`kanë për t`i harruar!

Ata mund të bëhen dhe postierë,  
Aftësi kanë letra në çdo vend për të dërguar,  
Kështu Xha Dino na rrëfen e rrëfen...  
Për Pëllumbin Ilir, ndër shekuj të adhuruar!

## SHQIPONJËS

Krahëgjjerë e truplehtë,  
Gjithandej qiellin sundon.  
Me sytë si gjilpërë,  
Kufijtë e atdheut mbron.

Me dekada, krenare ti,  
Në beteja të ashpra e barbare.  
Me gjak shkrove histori,  
E jona legjendë, o fitimtare!

Shqiponjë, mbretëreshë atdheu,  
Që sundon në qiell e tokë.  
Kurrë s`të trembi ty armiku,  
Trimëreshë, që s`e gjen ndër shokë!



## DHEL PRA

Ndoshta nuk jam e shpejtë,  
Trime dhe ndoshta s'jam,  
Por për dredhi në këtë jetë,  
S'ka se kush ma kalon.

Korbit djathin ia morra,  
Vetëm pse e lavdërova.  
Në degë të pemës e lash,  
Të këndoj e të krokas.

Ujku me dredhi ia punova,  
Qypin me mjaltë ia vodha.  
Pogaçen e shijshme e gatova,  
Mjaltin me pogaçe e gllabërova.

Shqiponjën me bisht e mashtrova,  
Pas bishtit u gënjye e fluturoi e mjera.  
Kokën time si gjithmonë e shpëtova,  
Te lëkurëtari, lëkurën nuk e dërgova.

## ARIU

E trashë dhe dembele,  
Mua shpesh më thonë.  
Ndaj, kush dëshiron të provojë,  
Një garë me vrap në maratonë.

Lepurin, sorkadhen e dhinë,  
Në racion çdo ditë i kam.  
Vetë në kuzhinë nuk më vijnë,  
S`i gjuaj me armë, por me vrap i kap.

Kam forcë, dhe kush nuk më sulmon,  
Madje, nuk guxojnë as t`më afrohen.  
Se po që se nga gjumi dikush më zgjon,  
Shpejtë për të, ata do të pendohen!

## FLUTURAT

Fluturat laroshe, qiellit fluturojnë,  
Sikur balerinat, në skenë të vallëzojnë,  
Të duken, thujse janë në garë,  
Kush më e bukur, ndër to do të dalë.

Eh sa bukur, qiellin e kanë zbukuruar,  
Në valle të hedhura, me krahët e shkruar!  
Edhe lulet në kopsht, ua kanë lakminë,  
Ndaj presin me ëndje, mbi petale t`u rrinë.

Presin edhe bletët, për t`i shoqëruar,  
Bukurinë luleve, më për t`ua shtuar.  
Që flutura e bletë, livadheve të bredhin,  
Nektarin nga to, me ëndje ta mbledhin!

## BILBILI

Sa bukur për të tjerët,  
Ti bilbil këndon!  
Veten mallëngjyeshëm,  
Pse në ferrë e vajton?

Ç`ndodh me ty,  
A s`më tregon,  
Se ç`të mundon?  
Ndoshta të mungon,  
E shtrenjta liri!?

Fëmijë të dashur,  
Ja po j`ua them:  
- Edhe në liri, i lirë nuk jam,  
Edhe në ferrë e as kaçubë,  
Të lirë s`më lënë.  
Dhe nga vendlindja,  
Duan t`më largojnë,  
Se këngën time,  
S`duan ta dëgjojnë.

Për zë më të bukur,  
Zgjedhën, të korbit krokamë.  
Vajin e kukuvajkës, për melodi,  
E këngën time, në harresë e lanë!

Pse gjithë ky mllef,  
Nuk e kuptoj dot,  
Por kënga ime,  
Do të rojë për mot!

Sepse ajo,  
Ka çiltërsinë,  
Si zemra fëmijëve,  
Që ka dëlirësinë!

## QENGJAT

Eh, ç`kohë, dikur ishte,  
Kur qengja kishte në çdo shtëpi!?  
Vraponin e kërcenin,  
Sikur ju, sot, të dashur fëmijë!

Sa të lumtur e të lazduar,  
Tok me kecat bardhoshë,  
S`linin mal e s`linin fushë,  
Pa përshkuar qoshe më qosh!

Ca të bardhë e ca të zinj,  
Ca me trup lara-lara,  
Nëpër brigje e lëndina,  
Në mes veti bënin gara.

Kush më tepër do të vrapojë,  
Dhe kush garën do ta fitojë!

## KORBI

Jam i zgjuar, jam azgan,  
Ndër zogj korbi u lëvdua,  
Më i bukur ndër shpend jam,  
Ndaj zogjtë, zili më kanë mua!

Aty pari dhelpira kaloi,  
Lavdin e tij e dëgjoj.  
Dy, tre fjalë atij i tha;  
“Këngëtar, si ti nuk ka”.

Gjeraqina lart nga lisi,  
I thotë korbit, o i mjeri ti,  
Pa shiko se ç`pamje ke,  
Hapi pak, korb ato sy!

Veten të ditur mos e mbaj,  
Se ka më të ditur se ti vëlla.  
Lëri fjalët e mos krokit,  
Krahëve jepu, nga ky vend ik.

## QUKAPIKU

Dru më dru shkon,  
Krimbat u'a pastron.  
Shpesh edhe pa i pyet,  
Lëkurën ua dëmton.

Qukapik sqepforti,  
Edhe degët u'a pastron,  
Me sqepin e tij  
Luan, si në bateri.



## UJKU DHE KALI

Në lëndinë kulloste kali,  
Barë të njomë aty shijonte.  
Punën e vet shikonte ai,  
Dhe kujt të keqen s`ia mendonte.

Nga larg vëzhgonte ujku,  
Dhe në vete veç mendonte.  
S`i t`ia bëjë sherrin atij,  
Që më lehtë ta sulmonte!

Kali ujkun e vërejti,  
Dhe qëllimin ia kuptoi,  
Dhe hartoi shpejt një plan,  
Sesi mund që ta mashtrojë.

U shtir ai si i lënduar,  
Kinse gjembi i hyri në këmbë,  
Edhe sillej sikur mundohej,  
Që ta nxjerr gjembin me dhëmbë.

Dhe në çast, e thirri ujkun.  
Tha: eja të lutem më ndihmo!  
Se këmba më është ënjtur,  
Ndaj, gjembin ti ma largo!

Dhe ujku i gëzuar,  
Me vrap te kali u afrua,  
Sa u var që ta shohë gjembin,  
Në kokë nga kali u shkelmua.

Nga ajo ditë ujku më nuk besoi,  
Se gjembi patkoin e kalit, mund ta shpojë.  
Tha: kurrë më në jetën time,  
Rolin e nallbanit nuk do ta aktroj!

## I PARI JAM

Filozof i madh Lejleku na doli,  
Anekënd botës, tha, vende kaloj.  
Male e lugina i kam studiuar,  
Në pranverë e vjeshtë, duke fluturuar.

Ende fjala, në tokë pa i ra,  
Dallëndyshja I'a priti:  
O këmbëgjatë, o mendjelehtë,  
Po Ne, male e dete, a nuk i kalojmë?  
Në shtegtim, ne a nuk shkojmë?  
Zogj shtegtarë edhe neve na thonë,  
Edhe Ne, rrugën e kemi mësuar,  
Dhe njohuri, për to kemi fituar!

Ndaj, te shpesët tjera,  
Ky lavd s`mund të kalonte,  
Sepse lejleku, të mirat,  
Për vete deshi t`i përvetësonte!

Kështu lejleku,  
I turpëruar mbeti,  
Se përkrahje,  
Nga askush nuk gjeti!

E pra, fëmijë,  
Të keni kujdes!  
Sepse, lavdi,  
I keq është si ves!

## AKREPAT

Të tre akrepa në garë janë,  
I pari, më i madhi,  
Një herë rreth e rrotull shkon,  
Të dytin, akrepin e minutave,  
Të bëjë një hap e detyron,  
Dhe, hap pas hapi,  
Gjashtëdhjetë të tilla i bën.

Akrepi i tretë ecën më ngadalë,  
Heshtur pa mos thënë as dhe një fjalë!  
Nga një numër në tjetrin ai kalon,  
Se ka kaluar një orë, neve na tregon.

Kështu akrepat, pa ndalë qarkullojnë,  
Dhe rrugëtimin e tyre kurrë s`e ndalojnë!  
Ndaj, janë të vlefshëm sa dhe vetë ora,  
Se tok me orën hijeshohet dora!

## GËRZHETA

E bukur si hyjni  
Gjysmë peshk gjysmë njeri.  
Në Gjol kishte jetuar,  
Ti afrohej, kush s'kishte guxuar.

Në mëngjes kur agonte dita,  
Gërzheta shkonte në Shulla.  
Në një gur ulej e pushonte,  
Rrezet e diellit aty t'i shijonte!

Kur dikush afrohej,  
Zhytej në Gjol dhe aty rrinte,  
Derisa rreziku të kalonte.

Askush atë se kishte pa,  
Dhe askush se kishte takuar,  
E fshehur në ujë kishte qëndruar.

Një Bari, një azgan,  
Kishte hartuar një plan.  
Kurthin Gërzhetës i'a kishte bë,  
Në shtëpi e kushte dërguar,  
Me Gërzhetën ishte martuar.

E bukur e punëtore,  
Nga goja si doli një fjalë,  
Të gjithë e ngacmonin,  
Se, nuse memece ke marrë.

Një ditë bariu e detyroi të flasë,  
Ose djalit kokën do t'ia presë,  
Atëherë foli, e i tha Gërzheta:  
Edhe disa ditë pa folur po të qëndroja  
Nga krijesë, në njeri do të shndërrohesha.

Gërzheta të shoqin e pyeti:  
Teshat e gjolit ku mi ke dërguar,  
Më ka marrë malli për t'i shikuar.  
Mallin nga shpirti pak ta largoj,  
Edhe një herë t'i prek e t'i shikoj.

I shoqi gaboi e i tregoi,  
Dhe me sy Gërzhetën në jetë se pa.  
Ajo veshi teshat e në liqen u kthye,  
Nga ajo kohë më nuk u pa,  
As në liqen, as në Shulla.

Edhe bariu një mësim mori,  
Sa do plan të mirë të kesh hartuar.  
Për jetë të jetës krijesa nuk bëhet njeri,  
Edhe pse me tradhti e solli në shtëpi.

## **Ëndrra e stinës**



## GJETHI I MËRZITUR

Një gjeth rrinte në vetmi,  
Në dimër, eh, ç`kishte përjetuar.  
Por krenar, ndjehej në degë shege,  
Se stuhive u kishte, rezistuar!

Edhe ngjyrën e kishte humbur,  
Ngjyrë ari tani kishte marrë.  
S` ishte i gjelbër si në pranverë,  
S` ishte i bukur më si më parë!

I thotë dega, gjeth or gjeth,  
Shumë i fortë t`i u tregove.  
Borë e erë kur drurët qethën,  
Ti stoik tek unë qëndrove.

Tani radha është të ikësh,  
Dhe të ikësh me kënaqësi,  
Se së shpejti vjen behari,  
T`më stolis me gjethe të rinj!

## PRANVERA

Nën kaçuba manushaqja,  
Pranverën paralajmëron.  
E llastuar nga rrezet e diellit,  
Nën hije petalet zmadhon.

Lulebora për karshi,  
Atë e shoqëron,  
Se me bukuritë e tyre,  
Natyren e zbukurojnë.

Bilbili thërret dallëndyshet,  
Në fusha e male,  
Bashkë t`ia marrin këngës,  
E të hedhin valle.  
Erdhi pranvera,  
Natyra gjelbëroi,  
Në lëndina qengjat,  
Eh seç i gëzoi!

Tej në bregore,  
Lumenjtë gurgullojnë,  
Si gjithmonë freski,  
Ata na dhurojnë.

Pranverë e bukur,  
Përplot hijeshi.  
Na fale ylberin,  
Na fale kënaqësi!

Ndaj, ne të duam,  
Dhe do të duam prore,  
Se largove dimrin,  
Dhe jetën e rinove!

## SHIU

Kur bie shiu,  
Njerëzit i mërzit,  
Po për mua shiu,  
Është gjallëri e rritë.

Por shiu i rrëmbyeshëm,  
Shkatërron gjithçka,  
Se për askënd ai,  
Fare mëshirë s`ka.

E kur ngadalë bie,  
Është plot dobi,  
Natyren hijeshon,  
Sjell dhe pastërti.

Ringjall edhe jetën,  
Bleron dhe natyrën,  
Fëmijët i gëzon,  
Ua shndrit fytyrën.

Edhe zogjtë pas shiut,  
Të lumtur fluturojnë,  
Qellin kaltërosh,  
Ata e zbukurojnë.

## NATË VERE

Ere e lehtë fryn,  
Në livadhet e vendit tim,  
Natë e bukur kjo e sotmja,  
Shikoj qiellin me yje plot,  
Edhe hëna më sodit.  
Ca tinguj melodie tej në horizont,  
Plotësojnë pasqyrën e vëzhgimit tim.

Sa e bukur kjo natë vere,  
Nën qellin e hapur kur qëndroj,  
I vetmuar me hënën kuvendoj,  
Dhe me yjet së bashku,  
Në qiellin e kaltër lundroj.

Net të bukura vere,  
Freski shpirti e gjallërie,  
Ringjallin kujtime djaloshare,  
Ringjallin kujtime rinie.

## VJESHTËS

Me ngjyrë ari e zbukuruar,  
Mirë se vjen stinë e uruar!  
Begati vjeshtë na solle,  
Dhe pa masë na gëzove!

Dhe zogjtë me këmbë të mbarë,  
Rrugë të gjata në shtegtim kanë marrë.  
Amanet na i lanë neve foletë,  
Si i lanë, në pranverë me i gjet.

Edhe bujku me turr e vrap,  
Bereqetin e vendos në dollap.  
Dimrin ta kalojë më mirë,  
Në pranverë të mos ta ketë të vështirë.

Edhe blegtori shumë i gëzuar,  
Pas tufës, shkon duke kënduar.  
Gjithë verës ka tubuar ushqim,  
Stallën e ka mbushur pa përtim.

Arusha iku në gjumë dimëror,  
Pasi ka siguruar ushqimin vjetor.  
Edhe ujku nga malet është larguar,  
Pas tufës se bagëtisë ai ka shkuar.

Kështu heshtas, vjeshtë erdhe,  
Ngjyrë të verdhë, natyrës derdhe.  
Shkollës ia hape dyert,  
T'i tubosh aty fëmijët!

## **BORA**

Nga qelli zbret me naze,  
Si nuse e zbukuruar!  
Ti o borë, bardhoshe,  
Kush të ka trazuar!?

Nga veriu i largët,  
Rrugën kush të trasoi,  
Dhe për në vendin tim,  
Kush ty ta tregoi!?

Të gjithë të presin,  
Borë, me padurim.  
Fëmijët e lagjes time,  
Rrëshqasin pa pushim.

Shpejt do të ikësh,  
Ti borë fatprerë!  
Dhe do t`ma kthesh,  
Të bukurën pranverë!



## DIMRIT

O dimër i acartë  
Me borë të kristaltë!  
Ç'bukuri të rrallë,  
Pse na solle, vallë!?

Mbulove shtëpitë,  
Male e fushë mbulove.  
Jorganin e bardhë,  
Përmbi to e shtrove.

Bredhin në oborr,  
Shumë e hijeshove,  
Kur në të bardhë,  
Edhe të e mbulove!

Edhe fëmijët, dimër,  
Fort i ke gëzuar,  
Se Vitin e Ri  
Kanë për ta festuar!

Veç zogjtë ta kanë frikën,  
Se vështirë gjejnë ushqim.  
Por, fëmijët e kujdesshëm,  
U dalin në ndihmë.

U ndërtojnë çerdhe,  
U hedhin ushqim prore.  
Që më lehtë ata,  
Ti kalojnë ditët dimërore.

Edhe Macja më s`gjuan mi,  
Nga acari, frika në asht i ka hy!  
Pranë koftorit, ajo është strukur,  
Oh sa qetë fle, macja e bukur!

Edhe Laroja u ankua,  
Më gjeni, tha, një strehë edhe mua,  
Mos të sëmurem, gripin mos ta marr,  
Që në pranverë i shëndosh të dal.

## DITË LULESH

Në livadhet e fshatit tim,  
Lulet kanë lulëzuar,  
Lule bora në mesin e tyre  
Petalet e saja ka zbukuruar.

Lule bora, luleshqerrat,  
Ç'më kujtojnë një tjetër moshë!?  
Kur së bashku në livadhe shkonim,  
Në Ditën e luleve, të thurnim kurorë.

Të rinjtë e të rejat,  
Rrugën kur merrnim për në kodrinë,  
Kënga jonë jehonte,  
Buzë bregut dhe në lëndinë.

Këndonim të për të rinjtë,  
Dhe për vashat këngë thoshim.  
Pleqtë e plakat i qortonim,  
E me vargje të këqijat i mallkonim.

Dhe në kthim degë shelgu merrnim,  
Ndër vathë e shtëpi i vendonim.  
Luteshim për shëndet, për bereqet,  
Për mirësi, mbarësi e lumturi,  
Gjatë tërë vitit, të kemi në shtëpi.

## LULEBORA

Çdo fëmijë e njeh,  
Se në abetare e sheh.  
Kur shkronjat mëson,  
Luleborën e takon.

Pa u shkri dëbora,  
Nën kaçuba çel.  
Dhe në natyrë,  
Kundërmon erë.

Nuk pret lulet tjera,  
Tok me to të bulojë,  
Se vjen po pranvera,  
Do vetë të na lajmërojë!

Dhe kur Dielli,  
E shkrin dëborën,  
Edhe lulet tjera,  
Nxjerrin kurorën.

Fëmijët të gëzuar,  
Në natyrë dalin,  
Mbledhin lule,  
Nënave t`ua falin!

## RRUSHI

Sapo fillon vjeshta,  
Rrushi piqet në vreshtë,  
Sa bukur ta shohësh,  
Varur kalavesh.

Të bardhë, të zi,  
Mbushur hardhitë plot,  
Mundi i vreshtarit,  
Nuk i shkoi kot.

Sepse tërë verës,  
Pa ndalë ai punon,  
Për djersën që derdh,  
Aspak nuk mendon.

E, ja punëtorit,  
Si shpërblim natyra,  
I fali plot rrush,  
I fali të mira.

Sepse punëtorët,  
Gjithkush i do,  
Ndaj dhe ne fëmijë,  
Të bëhemi si to.

## GËSHTENJAT E GJYSHES

Në një fshat, në Malësi,  
Për herë të parë te Gjyshja,  
Gështenjën e ëmbël shijova,  
Edhe sot kur e kujtoj,  
Jargët nga goja më shkojnë.

Të pjekura apo të ziera,  
Të shijshme janë.  
Po e shijove njërën a tjetrën,  
Fare dallim s'kanë.

Kujtime të pashlyera,  
Më mbetën nga vegjëlia,  
Kur me shokë e shoqe,  
Shkonim te malësia.

Sot më s`e kam gjyshen,  
E në malësi nuk shkoj.  
Por gjyshen dhe gështenjat,  
Kurrë s'mund t'i harroj!

*( Vështrim rreth librit me poezi për fëmijë, “Ëndërrime” të MuaxherHarunit, Tetovë 2024)*

## **Dashuria në udhët e dheut të atdheut tim**

Shkruan: Mr. Sadije Aliti

Koha jonë është thellësisht heroike dhe fëmija nga vetë natyra është i prirur për entuziazëm. Veprat heroike e tërheqin, e rrëmbejnë, e ngrejë peshë zemrën dhe fantazinë e tij. Vepra e letërsisë për fëmijë është para së gjithash art i fjalës, prandaj nuk duhet të lëmë anash këtë tipar, arti i një bote të çiltërt e fisnike ashtu siç është edhe bota e fëmijëve.

Pra, shkrimtari për fëmijë i ka të gjitha mundësitë që t’i japë lexuesit të vet ngjarje dhe karaktere heroike dhe duhet t’ia japë mirë, që të veprojë mbi mendjen dhe fantazinë e fëmijës, t’i zgjojë emocione të forta përmes përbajtjes së vargut.

Arti krijues për më të vegjëlit mbetet rrugëtim i pa zbuluar, rrugëtim i ndjenjës së dashurisë. Këtë ndjenjë e shpalos, e pikturon në një kolorit të bukur e të pasur edhe autori MuaxherHaruni në poezitë e përmbledhura në kopertinat e librit me titull “Ëndërrime”.

Zakonisht vjershat ndërtohen mbi një fabul të thjeshtë, por me aksion, ku fëmija, përmes personazheve imagjinare, sheh veten e tij në lodra e gëzime të çiltra. Vargu është konçiz e me ritëm të rrjedhshëm, aq sa fëmija, fare lehtë, mund t’i mbajë mend e t’i bashkojë me tingujt e një melodie.

Libri me poezi për fëmijë “Ëndërrime” është i ndarë në katër kapituj, si: Ëndrra e jetës, Ëndrra e atdheut, Ëndrra e shqiptonjës, Ëndrra e stinës.

Autori i çmon të rëndësishme të dorës së parë mesazhet poetike që dalin nga teksti letrar dhe për të vërtetën artistike që ai shprehet se shkrimtari nëpërmjet ngjarjeve dhe dukurive të trajtuara në veprën letrare nxjerr kuptime dhe zbulon një përbashkësi problemore ku përballet e drejta dhe e padrejta, përbashkësi këndvështrimesh mbi elementet origjinare, mbi konceptet e idealeve triumfuese.

Në kapitullin e parë “Ëndra e jetës” i këndohet botës së fëmijëve, jetës reale dhe asaj të imagjinuar që ata e kanë si një mbretëri, në të cilën jetojnë me dëshirat e tyre të pa zbuluara. Edhe hëna e dielli janë pjesë e kësaj jete, pasi me ta fëmijët flasin me lirshëm, janë shumë kureshtarë dhe duan të dinë me shumë nganjëherë se sa u lejon mosha e tyre. Janë në dilemë të madhe se kur të rriten çka do të bëhen, dhe me çfarë dhurate t’ a presin ardhmërinë, prindërit e gjyshi e gjyshja janë pikturuar në këto poezi.

Autori përbërës kryesor e ka gjuhën dhe mënyrën e shtjellimit të tekstit poetik nga ku dalin mesazhet, marrëdhëniet e fjalëve, shumësinë dhe nuancat kuptimore, ngjyrimet ndjenjësore e tingullore, përafrimin, ballafaqimin dhe përplasjen ose kundërvënien, ai për nënën shprehet te poezia : “MË TË SHITRENTËS”.

Cila vlen më shumë:  
- Një lule që rritet një vit,  
A fjalët e mira çdo ditë?!



Përshfaqet rrugëtimi i dashurisë në udhët e jetës që nuk kanë fund, aq më pak kur ky rrugëtim bëhet i përkryer e në veçanti në kërkim hyjnor, herë në qetësi e mall, në gëzim e hidhërim. Jetë të qëndisur me dashuri për dashurinë, qenësi, po dhe i krijon ato, që domethënë e pasuron përvojën e kohës së tij e të kohëve pas tij.

Në kapitullin e dytë “Ëndrra e atdheut” te fëmijët vjen në shprehje dashuria dhe motivi patriotik, i atdhedashurisë, i këndohet flamurit, alfabetit e Kongresit të Manastirit, nëntorëve historik, trimave e patriotëve, heronjëve kombëtar.

Letërsia për fëmijë është mision. Nuk është e lehtë. Jo, dokushdo mund “të trokasë” në këtë portë të shenjtë. Mesazhet, porositë dhe imagjinata ndërlidhen me performancat për të kuptuar arsyen, sepse dashuria tani ndaj natyrës, ndaj jetës, ndaj më të dashurve, që janë jetë e mbi jetëve për fëmijët. Të shohim pak motivin e atdhedashurisë se pa atdhe nuk ka dhe, nuk ka jetë e nuk ka gjallëri, poezia: “DHEU I ATDHEUT TIM”:

Sa dhe’ të bukur, ka ky atdhe,  
E ky Dhe’ ka ngelur jetim.  
Për ta punuar këtë dhe,  
Të ikën djemtë dhe vajzat,  
Në tjetër Dhe’, o Atdheu im!

O dheu i bukur i atdheut tim,  
Në dorë të kujt mbete,  
Tani, ti më dukesh,  
Më tepër se një jetim.

Na pikturohet rita e jetës, apo më mirë thënë jetohet e tashmja, duke pritur të nesërmen, udhëton drejt asaj që ka të bëjë me njohjen, me dëshirën për të zbuluar të vërtetën, tone lirike dashurie gjatë viteve. Jeta ëndërrimtare e shpirtit të përhumbur duke kërkuar shumë herë ëndrrën ta bëjë realitet para së gjithash gjuha, mënyra e perceptimit, e shtjellimit dhe e të shprehurit, thjeshtësia e mesazheve, loja që është e pranishme e që gërshetohet me humor të natyrshëm, që zgjojnë tek fëmijët kureshtjen, kënaqësinë, fisnikërimin dhe pasurimin shpirtëror.

Bota bimore e shtazore, krijimi i shoqërisë e miqësisë me kafshët e shpendët dhe fëmijët ndërthuret me vargjet e përmbledhura në kapitulline tretë me një emërtim simbolik “Ëndrra e shqiponjës”. Gara epike mes të shpejtit e të ngathëtit, breshka e lepuri, konkursi për zë më të bukur mes shpendëve, ariu e dhelpra, kënga e bilbilit e loja e fluturësdhe guximi i shqiponjës përshkruhen në poezitë e këtij kapitulli. Këtë e vërejmë te poezia “SHQIPONJËS”:

Me dekada, krenare ti,  
Në beteja të ashpra e barbare.  
Me gjak shkrove histori,  
E jona legjendë, o fitimtare!

Në rrjedhën historike të procesit letrar krijues e studimor, shumësia e fenomeneve dhe dukurive që u zhvilluan e po zhvillohen, në tërësinë e tyre lineare e të segmentuara, kanë prodhuar nëpër vite, vlera dhe të cilat kanë ndërtuar udhët e tyre, të cilat këto udhë janë të lidhura me faktorë historikë,

psikologjikë, sociologjikë, pra me realitete jashtë letrare dhe letrare.

Kapitulli i katërt “Ëndrra e stinës” përmbledh bukuritë e natyrës në të gjitha stinët e vitit. Poeti përshkruan luleborën, që paralajmëron ardhjene pranverës, freskinë pikave të shiut, nxehtësinë e verës, pasurinë e vjeshtës me rrush e gështenjat e gjyshes dhe dimrin me bardhësitë e natyrës. Poezia “NATË VERE” tregon se sa e bukur duket vera në fshat:

Sa e bukur kjo natë vere,  
Nën qellin e hapur kur qëndrojt,  
I vetmuar me hënën kuvendojt,  
Dhe me yjet së bashku,  
Në qiellin e kaltër lundrojt.

Autori ka paraqitur dhe sintetizuar qartë, saktë dhe bukur idetë, mendimet, e ato kanë fuqinë e frymëzimit në realitetin e krijuar, një udhëtim nëpër një botë të re, nëpër një peizazh sublim të mozaikut kompleks të ndjenjave, fenomene dhe dukuri letrare në diagramëne zhvillimit të tyre në dimensionin e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj.

Urojmë rrugëtim të mëtejme të vargut e të imagjinatës krijuese për autorin!

Mars 2024, Tetovë

## Pak biografi

### Muaxher Haruni



Lindi në fshatin Trebosh të Tetovës, shkollimin fillor katërvjeçar e kreu në vendlindje kurse nga klasa e pestë deri në klasë të tetë mësimin e ndoqi në Shkollën fillore “BrastvoEdinstvo” sot Shkolla fillore komunale “Migjeni” në Tetovë, më pastaj kreu Gjimnazin e Tetovës. Pas mbarimit të gjimnazit u regjistrua në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë Dega e

Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Me që në atë kohë u mbyllën shkollat u detyrua të braktis arsimimin e tij e të kthehet në vendlindje. Me hapjen e Universitetit të Tetovës është ndër studentët e parë që u regjistrua në Fakultetin Filologjik-Dega e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe. Pas mbarimit të fakultetit punësohet arsimtar në Shkollën fillore komunale “Fan Noli” të fshatit Trebosh.

Opusi letrar i tij është poezia dhe proza për fëmijë dhe të rinj, është redaktor dhe recenzent i mbi 25 veprave letrare të nxënësve të tij dhe të rinjve të tjerë nga fshatrat e Tetovës.

Krijimet letrare i ka të postuara në faqe të ndryshme sociale dhe në prëmledhje poetike tjera. Është libri i parë me poezi të cilin ua dedikon më të rinjëve, gjegjësisht nxënësve të shkollave fillore.

## PËRMBAJTJA

Ëndrra e jetës .....	3
DËSHIRA E ARMENDIT .....	4
MBRETËRIA IME .....	5
FAJI .....	7
ERA E DIELLI .....	9
RONI E HËNA .....	11
HËNËS .....	13
FËMIJËVE TË BOTËS .....	15
DUA TË DI.....	16
KURESHTARËT .....	17
Ç’TË BËHEM?.....	18
ËNDRRA IME.....	19
DUA.....	21
DHURATA .....	22
ARDHMËRISË .....	23
BUZËQESH .....	24
MË TË SHTRENJTËS .....	25
8 MARSII.....	26
PRINDËRVE .....	27
VITI I RI .....	28
DIKUR E SOT .....	29
KËNGË JEHO .....	30
FJALË E PUNË .....	31
FJALA .....	33
FËMIJËVE TË BOTËS .....	34
JUVE.....	35
HIDHËRIMI .....	36
KOHA FLET .....	37
MOS MË QUAJ POET .....	38
KUR SHKRUAJ VARGJE.....	39

POEZIA .....	40
POETI .....	41
PUNA .....	43
KËNGË MOJ .....	44
NË PUNË.....	45
PARAJA .....	46
GËNJESHTARI.....	47
RILINDJE.....	48
FLAKË PËRVËLUESE .....	49
Ëndrra e atdheut.....	51
NXËNËSI I SHKËLQYESHËM.....	52
NUMRAT .....	53
ALFABETIT.....	54
KONGRESI I MANASTIRIT .....	55
NËNTORIT .....	56
NDËR KOHËRA.....	57
VENDI IM.....	58
DHEU I ATDHEUT TIM.....	60
HERONJTË .....	61
Ëndrra e shqiponjës.....	63
GARË EPIKE .....	64
KONKURSI.....	66
DHELPRA DHE GJELI .....	68
STALLA .....	69
PËLLUMBAT .....	70
SHQIPONJËS.....	71
DHELPRA.....	72
ARIU.....	73
FLUTURAT .....	74
BILBILI .....	75
QENGJAT .....	77

KORBI.....	78
QUKAPIKU .....	79
UJKU DHE KALI .....	80
I PARI JAM.....	82
AKREPAT .....	84
GËRZHETA .....	85
Ëndrra e stinë.....	87
GJETHI I MËRZITUR.....	88
PRANVERA.....	89
SHIU .....	91
NATË VERE .....	92
VJESHTËS .....	93
BORA .....	95
DIMRIT .....	96
DITË LULESH.....	98
LULEBORA.....	99
RRUSHI.....	100
GËSHTENJAT E GJYSHES.....	101
Pak biografi.....	107





